REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SHIJAK

Nr. 876/1 **Prot.** **Shijak** 07/11/**2012**

Lenda : Kthim përgjigje

Drejtuar : Qendrës "Res Publica"

Në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju bëjmë me dije se:

Bashkisë Shijak nuk i është akorduar ndonjë fond i posaçëm nga buxheti i shtetit për përballimin e efekteve të Aktit normativ nr.3 datë 01.03.2012 "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara".

Njësia jonë vendore për mungesë fondesh nuk ka planifikuar banesa të reja për sistemimin e personave të pastrehë.

Numri i banesave sociale që ka aktualisht ka në dispozicion Bashkia Shijak është 2 (dy).

Lista e qytetarëve te pastrehë në qytetin tonë është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr 16 datë 07.06.1996. Bazuar në listën e lartëpërmendur numri i qytetarëve në pritje për përfitimin e një banese është 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë). Por duke marrë parasysh edhe kërkesat e reja të paraqitura nga qytetarë që plotësojnë kushtet për t'u përshirë në listën e të pastrehëve, ajo (lista) do të shtohet nëpërmjet miratimit në Këshillin Bashkiak.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

P/Bashkinë Shijak
Kryetari

Indrit BUKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE · BASHKIA · SHIJAK